



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 330 Prot

Tiranë, më 18.02 2015

URDHËR

Nr. 87 datë 17.02.2015

PËR

KRITERET E VLERËSIMIT PËR PERSONELIN PROFESIONIST NË QENDRA  
SHËNDETËSORE

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4 e nenit 102 dhe neni 119, në zbatim të Vendimit nr. 737, datë 05.11.2014 të Këshillit të Ministrave "Për financimin e shërbimeve shëndetësore publike të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimit të kujdesit shëndetësor" dhe Statutit të Qendrave Shëndetësore;

URDHËROJ:

1. Njoftimi për vendet e lira të punës për personel profesionist në Qendrat Shëndetësore, bëhet me mjetet e informimit publik dhe duhet të përmbajë të dhëna mbi: pozicionin vakant, kushtet që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacionin që duhet paraqitur, kriteret e vlerësimit të kandidatëve, si dhe vendin dhe kohën e dorëzimit të dokumenteve.
2. Dokumenta të detyrueshme për të konkurruar për një vend të lirë pune janë: diploma universitare, certifikata e notave, licenca e urdhrit të profesionistit, dëshmia e penalitetit, dhe raporti mjekësor. Nëse pozicioni i lirë është për mjek specialist atëherë kërkohet edhe certifikata/diploma e specialitetit.
3. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit, diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Vlerësimi me pikë i kandidatëve bëhet sipas kriterëve të parashikuara në lidhjet nr.1 dhe nr.2 që i bashkëlidhen këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



